



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 852/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-91012-10-23-2018, me objekt: “Blerje vegla pune dhe atrecatura per punonjësit e drejtorisë së shërbimeve publike”, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 05.11.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhe.

Ankimues: “Euro-Alb” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Kosovarëve”, Pallati TID, SHk.2, Ap.5, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: “Denisa Beshaj” PF.
Adresa: Rruga “Kavajës” Njesia Bashkiake nr.7, Pallati “Gora”, kati 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lezhë.
Adresa: Godina përballë Prefekturës, Lezhë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.10.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit, “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-91012-10-23-2018, me objekt: “*Blerje vegla pune dhe atrecatura per punonjësit e drejtorisë së shërbimeve publike*”, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 05.11.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhe.

II.2. Në datën 05.11.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr 11450/1 prot, datë 05.12.2018, si dhe sistemit elektronik të prokurimeve rezulton se në datën 12.11.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Paera” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
2. “Ekspo Sistem” shpk	Pa dokumentacion	skualifikuar
3. “Euro-Alb” shpk	1,217,910 lekë	skualifikuar
4. “Denisa Beshaj” PF	1,220,500 lekë	kualifikuar
5. “Stella” shpk	1,475,600 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 12.11.2018, operatori ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

- *Nuk permbush kriteret e vecanta te kualifikimit te kerkuar ne DST ne lidhje me furnizime te ngjashem.*

Ne piken 2.3.1 eshte kerkuar: 2.3.1 Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit në vlerën prej 40%, e fondit limit të vënë në dispozicion. Kur përvoja e ngjashme është e realizuar me institucione shtetërore, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë këtë kërkesë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e realizimit të kontratës lëshuar nga institucioni shtetëror ku të jenë pasqyruar të gjitha të dhënat që provojnë se kontrata është realizuar me sukses. ose Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Referuar listes se veglave te punes dhe te paisjeve te sigurise ne pune sipas shtojces nr 10 te DST- nga ana jone pervec veglave te punes jane kerkuar edhe pasijet e sigurise ne pune , (preventive 2) ndersa OE Euro Alb sh.p.k ne permbushje te kriterit te mesiperme ka paraqitur kontratat nr 3477 date 26.07.2016 , Kontrata date 03.05.2017 , Kontrata nr 4019 date 28.10.2016, Kontrata nr 2152 date 25.04.2017 , Kontrata nr 4583 date 03.07.2017, ku objekt i kontratave jane furnizim me materiale ndertimi, material per infrsaturtoren rrugore, blerje material te ndryshme pune etj, nuk ka paraqitur asnje dokument qe provon se ka realizuar furnizime te ngjashme per pajisje sigurie ne pune (veshje dhe paisje sigurie, pervec 3 pale kepuce pune dhe 5 pale kostume pune).

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...” vendosi te refuzoje oferten e OE “Euro Alb” sh.p.k per mospermbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

II.4.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr 11450/1 prot, datë 05.12.2018, rezulton se në datën 15.11.2018 operatori ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit si më poshtë vijon:

Më datë 12.11.2018, me anë të sistemit elektronik të prokurimeve publike, jemi njoftuar për rënditjen për procedurën e mësipërme ku rezultojmë të parët port ë skualifikuar.

Arsyeja për të cilën Autoriteti kontraktor na ka skualifikuar është mungesë furnizime të ngjashme. Theksojmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar furnizime të ngjashme dhe jo të njëjta. Këtë pikë shoqëria jonë e provon më së miri me kontratat e ngarkuara në sistem me nr 4585/3, datë 03.07.2017, me Komandën Mbështetëse të Ministrisë së Mbrojtjes dhe kontratën nr 4019, datë 28.10.2018 me Bashkinë Shijak.

Kërkojmë nga autoriteti kontraktor të bëjë rivlersimin e ofertave dhe të shpall ofertën tonë fituese.

II.4.2. Në datën 15.11.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 10774/1 prot, i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.4.3. Në datën 22.11.2018 operatori ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë si në autoritetin kontraktor.

II.5. Me shkresën me nr. 11450/1 prot, datë 05.12.2018, protokolluar me tonën me nr. 1766/2 prot, datë 07.12.2018, me objekt “Informacion mbi procedurën e prokurimit dhe ankesës së operatorit ekonomik ankimues Euro-Alb sh.p.k”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k. se: “Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit pikën 2.3.1 Furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit në vlerën prej 40 % të fondit limit”. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimimi, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

2.3.1 Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit në vlerën prej 40% , e fondit limit të vënë në dispozicion.

Kur përvoja e ngjashme është e realizuar me institucione shtetërore, Operatori Ekonomik do ta vërtetojë këtë kërkesë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e realizimit të kontratës lëshuar nga institucioni shtetëror ku të jenë pasqyruar të gjitha të dhënat që provojnë se kontrata është realizuar me sukses.

Ose

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 10 “Sasia dhe grafiku lëvrimit”, të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar si më poshtë vijon:

OBJEKTI:

Vegla pune

Nr.	Nr.analizes	Emertimi I materialit	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
Per riparimin e dritareve dhe dyerve alumini e druri (marangozet)						
1		Çeles ekzagonal 1.5-10mm	Komplet	1		
2		Kaçavida mekanike kryq	Komplet	1		
3		Kaçavida mekanike me maje te sheshte	Komplet	1		
4		Çekan gome	cope	1		
5		Matrapik 1500ë me dalte e punto	cope	1		
6		Matrapik 1500ë me goditje	cope	1		
7		Zdrukth horizontal 720ë	cope	1		
8		Sharre vertikale	cope	1		
9		Sharre rrethore	cope	1		
10		Luçidues felisati	cope	1		
11		Pistolet perçinoses	cope	4		
					Shuma1	
Per riparimin e çatise dhe ullugeve						
1		Shkalle dyshe alumini me kombinim (H=8m)	cope	1		
2		Trapon me goditje me mandrino me çeles 1010ë	cope	1		
3		Dara	pale	1		
					Shuma2	0

Per riparimin e mureve dhe lyerjen e tyre					
1		Pastrues muresh (spatula) 50x80x100x120	cope	2	
2		Rule boje me bisht teleskopik 3m	cope	20	
3		Furçe per lyerje me boje me bisht plastike	cope	10	
4		Skaf boje plastike	cope	5	
5		Govate llaçi	cope	2	
6		Mistri me bisht	komplete	2	
7		Berdaf per bojak 230x100x10mm	cope	6	
8		Shufra perzjeres kolli Ø140X590mm	cope	2	
Shuma3					0
Per mirmbajtjen e oborreve dhe terreneve sportive					
1		Kazma	cope	4	
2		Lopata	cope	10	
3		Nivelues alumini 80cm	cope	2	
4		Meter inox I gomuar 10mx25mm	cope	4	
5		Kreher kopshti 30-50cm	cope	2	
6		Fshese plastike	cope	2	
7		Kova llaçi	cope	4	
8		Motokorse me dy kohe (51.7cc;1.45kë)	cope	1	
9		Karroce dore	cope	4	
Shuma4					0
Per hidrauliket dhe kaldaistet					
1		Çelsa hidraulik anglez 48"	cope	2	
2		Sharre dore hekuri me doreze druri300mm	cope	6	
5		Fresibel I vogel 600ë	cope	2	
6		Furçe e vogel smalti me bisht druri	cope	4	
7		Zhbllokues lavamani (9mmx30m)	cope	2	
8		Pompe nen vakum	cope	3	
9		Instrument mates (shirit mates)	cope	2	
Shuma5					0
Per punetoret e fsheses					
1		Kaci e xinguar per mbledhjen e mbeturinave	cope	20	
2		Fshesa plastike	cope	40	
3		Karroce pastrimi	cope	20	
Shuma 6					0
Per elektricitat					
1		ICE elektronike dixhitale AC/DC	cope	7	

2		Gershere teli elektrik(me inoksi e gishteza te izoluar)	cope	7			
3		Pinceta rryme	Komplet	1			
						Shuma 7	0
						Shuma totale	0
						T.V.SH 20%	0
						TOTALI	0

OBJEKTI: Paisjet e sigurisë në punë

Nr.	Nr.analizes	Emertimi I materialit	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
Produktet te grupit mjekesor						
1		Kutia e ndihmes se shpejte	cope	1		
2		Komplet Fikse zjarri	cope	1		
Paisje te mbrojtjes se kokes, syrit, duarve,kembeve dhe kunder renies nga lartesisit.						
1		Mbrojtese koke	cope	60		
2		Syze pune mbrojtese	cope	30		
3		Doreza pune te thjeshta	pale	120		
4		Doreza rezistente ndaj prerjeve	pale	8		
5		Kominoshe pune me mbrojtese gjuri	cope	30		
6		Kominoshe te thjeshta	cope	21		
7		Mushama shiu	cope	30		
8		Jelek fosforeshent me logo te bashkise	cope	30		
9		Komplet paisje sigurie kunder renies	cope	30		
10		Kufje mbrojtese	pale	30		
11		Xhepa me hapje/mbyllje	cope	10		
12		Syze saldimi	cope	2		
13		Ganxha	cope	30		
14		Litar sigurie me 3 thurje -20m	cope	60		
15		Çizme te gjata deri ne bel	cope	1		
		Çizme pune	cope	20		
16		Kepuce pune	pale	60		
17		Maske mbrojtese me valvol	cope	30		
Produkte te sigurimit te trafikut						
1		Shirit bllokues paralajmerues	cope	10		
2		Trekendesh paralajmerues	cope	2		
3		Tabela sigurie (drejtim I detyruar)	cope	2		
4		Tabele sigurie(ketu punohet)	cope	2		
5		Tabele sigurie(kujdes puntor)	cope	1		
6		Drita paralajmeruese	cope	2		

7	Kon kufizuese 50 cm	cope	4		
				Shuma	0
				T.V.SH-ja	0
				Totali	0

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar si më poshtë:

1- Kontratë Furnizim Malli me Nr. 4585/3 prot, datë 03.07.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor Komanda Mbështetëse dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt Blerje materiale për mirëmbajtje kazermash”, me vlerë 45,806,469 lekë pa tvsh, kontrata është realizuar dhe përfunduar brënda afateve ligjore midis palëve kontraktuese.

Vërtetim Realizimi Nr 9757/1 prot, datë 29.12.2017, lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Komanda Mbështetëse, në të cilin citohet se kontrata është realizuar për sasin e planifikuar, në afat dhe brënda kushteve të kontratës.

Faturë TVSH-je me Nr. 11, datë 26.07.2017 dhe me Nr serial 46096811 lëshuar në favor të Blersit “Komanda Mbështetëse Reparti Ushtarak 4001”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 16,179,119 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 19, datë 07.09.2017 dhe me Nr serial 46096819 lëshuar në favor të Blersit “Komanda Mbështetëse Reparti Ushtarak 4001”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 15,784,873 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 22, datë 18.09.2017 dhe me Nr serial 46096822 lëshuar në favor të Blersit “Komanda Mbështetëse Reparti Ushtarak 4001”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 13,679,127 lekë pa tvsh.

2- Kontratë Furnizim Malli me Nr. 4019 prot, datë 28.10.2016, lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Shijak dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt Blerje materiale të ndryshme pune”, me vlerë 7,395,001 lekë pa tvsh, kontrata është realizuar dhe përfunduar brënda afateve ligjore midis palëve kontraktuese.

Vërtetim Realizimi datë 12.05.2017, lëshuar nga Bashkia Shijak, në të cilin citohet se kontrata është realizuar me cilësi dhe brënda afatit të parashikuar.

Faturë TVSH-je me Nr. 30, datë 17.11.2016 dhe me Nr serial 18158333 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Shijak”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 2,264,685 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 33, datë 29.12.2016 dhe me Nr serial 18158336 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Shijak”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 1,413,084 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 36, datë 21.02.2017 dhe me Nr serial 18158339 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Shijak”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 1,687,882 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 04, lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Shijak”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 663,630 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 16, lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Shijak”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 1,365,679 lekë pa tvsh.

3- *Kontratë Furnizim Malli datë 02.04.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Berat dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt Blerje materiale ndërtimi”, me vlerë 4,546,980 lekë pa tvsh, kontrata është realizuar dhe përfunduar brënda afateve ligjore midis palëve kontraktuese.*

Vërtetim Realizimi nr 10/5 prot, datë 12.05.2017, lëshuar nga Bashkia Berat, në të cilin citohet se kontraktori ka përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale të parashikuara brënda afatit dhe me cilësinë e kërkuar.

Faturë TVSH-je me Nr. 1, datë 04.05.2017 dhe me Nr serial 46096801 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Berat”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 2,957,000 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 2, datë 04.05.2017 dhe me Nr serial 46096802 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Berat”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 419,350 lekë pa tvsh.

Faturë TVSH-je me Nr. 3, datë 05.05.2017 dhe me Nr serial 46096803 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Berat”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 412,800 lekë pa tvsh.

4- *Kontratë Furnizim Malli nr 2152 prot, datë 25.04.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Maliq dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt Blerje materiale ndërtimi”, me vlerë 2,976,470 lekë pa tvsh, kontrata është realizuar dhe përfunduar brënda afateve ligjore midis palëve kontraktuese.*

Formular Vlerësimi, lëshuar nga Bashkia Maliq, në të cilin citohet se kontraktori ka përmbushur kontratën në afat dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Faturë TVSH-je me Nr. 47, datë 29.04.2017 dhe me Nr serial 18158350 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Maliq”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 2,976,470 lekë pa tvsh.

5- *Kontratë Furnizim Malli nr 3477 prot, datë 26.07.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Maliq dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt Blerje materiale ndërtimi”, me vlerë 3,888,888 lekë pa tvsh, kontrata është realizuar dhe përfunduar brënda afateve ligjore midis palëve kontraktuese.*

Formular Vlerësimi, lëshuar nga Bashkia Maliq, në të cilin citohet se kontraktori ka përmbushur kontratën në afat dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Faturë TVSH-je me Nr. 26, datë 02.08.2016 dhe me Nr serial 18158329 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Maliq”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 3,888,888 lekë pa tvsh.

6- *Kontratë Furnizim Malli nr 2844 prot, datë 03.05.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Krujë dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt “Blerje materiale për infrastrukturën rrugore të Bashkisë Krujë”, me vlerë 1,612,400 lekë pa tvsh, kontrata është realizuar dhe përfunduar brënda afateve ligjore midis palëve kontraktuese.*

Faturë TVSH-je me Nr. 32, datë 28.12.2017 dhe me Nr serial 46686832 lëshuar në favor të Blersit “Bashkia Krujë”, nga shitësi “Euro-Alb” shpk, në vlerën 1,611,320 lekë pa tvsh.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës[...].”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

III.1.5. Në nenin 27, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave”, parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.6. Në nenin 27 pika 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.7. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në plotësim të dëshmimeve të eksperiencave të ngjashme, operatori ekonomik ankimues “Euro-Alb” shpk ka dorëzuar në SPE, **Kontratën** me Nr. 4585/3 prot, datë 03.07.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor “Komanda Mbështetëse” dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtje kazermash”, me vlerë 45,806,469 lekë, shoqëruar me Vërtetim Realizimi Nr 9757/1 prot, datë 29.12.2017 dhe faturat tatimore të shitjes nr. 11, 19, 22. **Kontratën** me Nr. 4019 prot, datë 28.10.2016, lidhur midis autoritetit kontraktor “Bashkia Shijak” dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt “Blerje materiale të ndryshme pune”, me vlerë 7,395,001 lekë pa tvsh, shoqëruar me vërtetimin e realizimit të kësaj kontrate me datë 12.05.2017 dhe faturat tatimore të shitjes nr. 04, 16, 30, 33, 36. **Kontratën** datë 02.04.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor “Bashkia Berat” dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, me vlerë 4,546,980 lekë pa tvsh, shoqëruar me vërtetimin e realizimit të kësaj kontrate me nr 10/5 prot, datë 12.05.2017 dhe faturat tatimore të shitjes nr. 1, 2, 3. **Kontratën** me Nr 2152 prot, datë 25.04.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor “Bashkia Maliq” dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, me vlerë 2,976,470 lekë pa tvsh, shoqëruar me formularin e vlerësimit të kësaj kontrate dhe faturën tatimore të shitjes nr. 47. **Kontratën** me Nr 2844 prot, datë 03.05.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor “Bashkia Krujë” dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt “Blerje materiale për infrastrukturën rrugore të Bashkisë Krujë”, me vlerë 1,612,400 lekë pa tvsh, shoqëruar me faturë tatimore shitje nr 32. **Kontratën** me Nr. 3477 prot, datë 26.07.2017, lidhur midis autoritetit kontraktor “Bashkia Maliq” dhe operatorit ekonomik “Euro-Alb” shpk, me objekt “Blerje materiale ndërtimi”, me vlerë 3,888,888 lekë pa tvsh, shoqëruar me formularin e vlerësimit të kësaj kontrate dhe faturën tatimore të shitjes nr. 47. Nga verifikimi i kryer, KPP konstaton se me anë të dokumentacionit të mësipërme të dorëzuar, ankimuesi ka dëshmuar se nga ana e tij janë bërë shitje të artikujve sipas preventivave në shtojcën 10 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” të dokumentave standarte të tenderit objekt ankimi, referuar kontratave të mësipërme me autoritete të ndryshme kontraktore të cilat janë të shoqëruara me fatura dhe të pranuar nga autoritetet kontraktore. Mallrat objekt prokurimi të kërkuara nga autoriteti kontraktor janë vegla dhe pajisje pune, me sasi të përkatëse për cdo produkt. Referuar objektit dhe preventivave të kontratave të mësipërcituara rezulton se këto kontrata janë të realizuara me sukses dhe në përputhje me afatet e përcaktuara. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar dëshmimeve të eksperiencës së mëparshme të dorëzuar të realizuar ankimuesi ka provuar se ka

furnizuar mallra të cilat për nga natyra janë të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit. Në drejtim të dëshmisë së eksperiencës së mëparshme, të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit, KPP gjykon se, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Në rastin konkret, KPP gjykon se neni 46 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, është vërtetimi i eksperiencës së mëparshme të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. KPP gjykon se me, anë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ankimuesi ka vërtetuar se ka kryer me sukses, furnizime të ngjashme në përputhje me përqindjen e kërkuar nga autoriteti kontraktor, (40 % të vlerës së fondit limit të kontratës së prokuruar).

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Euro-Alb” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Euro - Alb” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-91012-10-23-2018, me objekt: “Blerje vegla pune dhe atrecatura per punonjësit e drejtorisë së shërbimeve publike”, me fond limit 1,500,000 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 05.11.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Lezhe.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Euro-Alb” sh.p.k
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1766 Protokoli, Datë 22.11.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha